



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
SEKTORI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, LETRAVE DHE PLATFORMËS
SË BASHKËQEVERISJES

Nr.8028/1 prot.

Tiranë, më 03.09.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. Sh. Z.

Adresa: Rruga “Mihal Grameno”,

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ju sqarojmë si më poshtë:

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me vendimet nr. 11354, datë 27.09.2023 dhe nr. 11354/1, datë 20.12.2023, ju ka caktuar pension pleqërie me datë fillimi 28.07.2023, masë fillestare 19.349 lekë në muaj dhe me 27 vjet e 3 muaj periudhë sigurimi.

Në llogaritjen e vjetërsisë janë përfshirë periudhat e mëposhtme:

- 18.05.1982 – 25.12.1982: Fabrika e Rushit Këlcyrë
- 01.04.1983 – 01.07.1984: Këshilli Popullor i Qytetit Këlcyrë
- 01.02.1985 – 30.06.1985: Këshilli Popullor i Qytetit Këlcyrë
- 01.11.1987 – 01.05.1988: Këshilli Popullor i Qytetit Këlcyrë
- 03.05.1988 – 15.01.1994: Këshilli Popullor i Qytetit Këlcyrë + Asistencë
- 01.03.1997 – 01.10.1997: Bashkia Këlcyrë
- 01.10.1997 – 01.01.1998: Bashkia Këlcyrë
- 01.01.1998 – 20.04.1999: Bashkia Këlcyrë + Asistencë
- 15.07.2004 – 10.05.2008: Rezidenca Studentore Universitare
- 01.10.2010 – 28.07.2023: Drejtoria Arsimore Tiranë

Në llogaritjen e vjetërsisë nuk është përfshirë periudha 01.01.1994 – 31.12.2004, brenda së cilës keni qenë e siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi në Njësinë Administrative Këlcyrë. Ky përjashtim bazohet në faktin se për këtë periudhë duhet Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi ose në Përdorim sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, në emër të z. S. Z., i cili në bazë të gjendjes familjare të datës 01.08.1991 ka qenë kryefamiljari, dhe ju keni qenë në ngarkim të tij.

Sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, dhe pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 02.08.1991, toka është ndarë përpjestimisht për çdo familje sipas numrit të frymëve më datë 01.08.1991.

Çertifikata për vërtetim pronësie, administruar në dosjen e pensionit, sipas listës bashkëngjitur, tregon se bashkëpronare e pasurisë 216.000 m² kullotë ishte M. Z. (vjehrra) më datë 03.10.2007, ndërsa çertifikata për vërtetim pronësie në emrin tuaj për 8.500 m² kullotë është e datës 23.03.2017, kurse periudha për të cilën jeni siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi është 01.01.1994 – 31.12.2004.

Kushtet për t'u siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi sipas VKM-së nr. 1114, datë 30.07.2008, janë:

1. *Mosha nga 16 vjeç deri në moshën për pension pleqërie sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar;*
2. *Të mos jeni i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, të banoni në të njëjtin nënqark ku është toka në pronësi ose përdorim dhe të zhvilloni veprimtari bujqësore ose blegtoje;*
3. *Në rast se toka ndodhet në nënqark fqinj, të mos jeni i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, të banoni në fshat dhe të zhvilloni veprimtari bujqësore ose blegtoje.*

Sa më sipër. periudha 01.01.1994-31.12.2004 që jeni siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi, në Njësinë Administrative Këlcyrë do njihet si periudhë e vlefshme kontributive nëse keni disponuar tokë për këtë periudhë, sipas të gjitha ligjeve të marrjes së saj.

Gjithashtu, për këtë periudhë ju mund t'i drejtoheni me kërkesë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për konvertim në sigurim vullnetar, sipas pikës 3, të VKM nr.551, datë 27.07.2016 “Për disa ndryshime e shtesa në VKM nr.77, datë 28.1.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i shëndetësor”, të ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se:

Në rastet kur nga data e pagesës së sigurimit si e vetëpunësuar në bujqësi e deri në datën e konstatimit apo datën e kërkesës drejtuar organeve të sigurimeve shoqërore kanë kaluar pesë vjet, me marrëveshje midis palëve, shumat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesave të paguara konvertohen si periudha sigurimi në nivel minimal në skemën e sigurimit shoqëror vullnetar me kuotat e kontributit të kësaj skeme të viteve përkatëse korresponduese, për të cilat është bërë sigurimi si i vetëpunësuar në bujqësi.

Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin